

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Specialist II, Drejtoria e Kontrollit të Terrenit, Tirana Jug, Zona III, (Kategoria e pagës IV-a).

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); VKB Nr.169, datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë Bachelor (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Specialist i II-të varet nga Përgjegjësi i Sektorit dhe kryen këto detyra:

1. Zbaton programin e punës sipas miratimit nga drejtori i drejtorisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
2. Kontroll të territorit të Bashkisë Tiranë në lidhje me situatën ndërtimore;
3. Inspekton në mënyrë të vazhdueshme territorin e Njësisë Administrative në të cilin është caktuar nga Drejtori i Kontrollit të Terrenit dhe Kryeinspektori;
4. Trajton ankesat e marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizik dhe juridik. Merr masa për zgjidhjen e tyre;
5. Zbaton programin e punës të hartuar nga Përgjegjësi i Sektorit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e inspektimit.

Dokumentat që aplikanti për Specialist II në Drejtorinë e Kontrollit të Terrenit, Tirana Jug, Zona III, duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë Bachelor, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit të përcillet njësimi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Vërtetim i aftë për punë;
7. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 11.04.2025 **ora** 14.00.